



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Pedagogji

Ngarkesa orare: 3 kredite, 40 ore; 20 ore leksione; 20 ore seminare

Viti / Semestri : Viti III, semestri I

Tipi i Modulit : Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor - Gjuhe-Letersi-Civilizim

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT- së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky modul shërben si hyrje në shkencën e pedagogjisë në mënyrë që studentët të zbulojnë dhe të përvetësojnë njohuritë dhe konceptet bazë të pedagogjisë së përgjithshme: përkufizimi, objekti i studimit dhe parimet e përdorimit të pedagogjisë si disipline më vete. zbulimi i modeleve të mësimave që janë ndërtuar dhe rrjedhin nga evoluimi i tipeve të pedagogjisë.

Objektivat specifike lëndore:

-Ky modul synon të pajisë studentët e degës së Mësuesisë me njohuri të përgjithshme pedagogjike që do t'u shërbejnë si një bazë solide për formimin e tyre të mëtijshëm në studimet e thelluara specifike në ciklin e dytë të studimeve universitare si mësues të ardhshëm të gjuhës frënge për shkollat e mesme.

-Të njihen me tipet e pedagogjive, tiparet e tyre karakteristike, parimet dhe zbatimin e tyre në klasë.

-Njohja me modelet e mësimave që janë konceptuar sipas zhvillimit të tipeve të pedagogjive.

Publiku i synuar: Studentë të Ciklit të Parë, viti i III, Bachelor.